



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 7725 prot.

Vlorë, më 19.05.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____. 2025

**PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË
BANESAVE SHTETËRORE TË PAPRIVATIZUARA**

Këshilli i Bashkisë, në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » të ndryshuar, neni 77/1,a, të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, pasi mori në shqyrtim vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë dhe materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ;

V E N D O S I

1. Të miratojë privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara për qytetarët me të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.
2. Të miratojë vlerën e apartamentit, që do të privatizojnë këta qytetarë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.banese	Struktura	Sipërfaqja/ m2	Vlera apartam. (lekë)	VL.truallit lekë	VL.plotë (lekë)
1	Drita	Dervish	Dosti	1084	1+1	49,70	25540	81584	107124
2	Kastriot	Hasim	Bylyshi	595	2+1	78	40226	118461	158687
3	Bashkim	Gjysho	Mahmutaj	602	garsoniere	24,80	0	171016	171016
4	Qani	Pasho	Latifaj (Trashëgimtarët)	98	1+1	56	0	78778	78778

KRYETAR

Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Mbi projekt-vendimin "Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara"

Pranë Bashkisë Vlorë kanë paraqitur kërkesat për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara shtetasit si më poshtë:

1. Drita Dosti për apartament me strukturë (1+1), i ndodhur në pallatin nr.1084, shkalla e parë, kati i pestë, nr.19, i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Sipas plan rilevimit të hartuar nga ing.top.i liçensuar sipas matjeve në vend ky apartament është pasuria me Nr.54/92+1-19, ZK 8605, me sipërfaqe 49,70 m2, me vendndodhje lagja "28 Nëntori", rruga "Anita Bitri", Rajoni Nr.5 Vlorë.
2. Kastriot Bylyshi për apartamentin me strukturë (2+1), pallati nr.595, shkalla 4. kati 5, apartamenti nr.13, i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Është pasuria me Nr.44/180+4-13, ZK 8601, me sipërfaqe 78 m2.
3. Bashkim Mahmutaj për apartament me strukturë garsonierë, me sipërfaqe 24,80 m2, apartamenti nr.1, i ndodhur në banesën njëkatëshe nr.602, lagja "Pavarësia", rruga "Abdyl Frashëri". Është pasuria me Nr.8/36+1-2, ZK 8602.
4. Qani Pasho Latifaj, ka ndërruar jetë, kërkesa është paraqitur nga bashkëshortja e tij në emër të trashëgimtarëve. Apartament i poseduar sipas kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992, me strukturë (1+1), me sipërfaqe 56 m2, i ndodhur në fshatin Shushicë. Është pasuria me numër 163/32+2-3, ZK. 3446 Shushicë.

Shtetasit sa më sipër kanë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social» të ndryshuar, neni 77/1,a, në VKM Nr.179 datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore".

1. Vërtetimin se personi ka pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992.
2. Çertifikatë familjare e 1.12.1992 dhe çertifikatë familjare aktuale.
3. Planimetri dhe plan rilevimi të banesës të hartuar nga topograf i liçensuar.
4. Në rastin kur personi që ka pasur kontratë qiraje me shtetin ka ndërruar jetë, dëshmia e trashëgimisë ligjore e nënëshkruar nga noteri.

Sipas akteve ligjore sa më sipër, vlera e privatizimit të banesës përbëhet nga ;

Vlera e privatizimit të truallit + vlera e privatizimit të apartamentit si ndërtesë.

Tarifa e privatizimit të truallit në përputhje me aktet ligjore sa më sipër është 1080 lekë/m² për qytetin e Vlorës dhe 0,3x1080l/m² për banesën e ndodhur në fshatin Shushicë.

Në rastin e banesave me dy ose më shumë kate vlera e truallit që i takon të paguajë familja përcaktohet nga koeficienti i bashkëpronësisë, sipas kuotës së pjesëmarrjes në bashkëpronësi.

Tarifa e privatizimit si ndërtesë përcaktohet në bazë të kategorisë dhe strukturës së apartamentit dhe korrigjohet në bazë të nivelit të banimit dhe vendndodhjes së apartamentit në godinë.

Vlera e privatizimit shumëzohet me indeksin e korrigjimit të çmimeve, duke marrë për bazë muajin dhjetor 1992.

Vlerat e privatizimit janë përcaktuar veçmas për secilën nga familjet dhe janë shënuar në tabelën pjesë e këtij projektvendimi.

Sa më lart, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e projektvendimit për ti hapur rrugë regjistrimit në pronësi të këtyre apartamenteve për familjet që kanë paraqitur kërkesë pranë Bashkisë Vlorë.

Konceptoi: *D.Mustafai*

Miratoi: *Z.Selmani*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 7725 prot.

Vlorë, më 19.05.2025

MIRATOHET
KRYETAR
Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 5, datë 14.5.2025

**PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË
BANESAVE SHTETËRORE TË PAPRIVATIZUARA**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » tw ndryshuar, neni 77/1,a, të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, pasi mori në shqyrtim dosjet dhe dokumentacionin përkatës të qytetarëve, që kanë paraqitur kërkesat për privatizimin e banesave shtetërore tw paprivatizuara ;

KONSTATOI SE

- I. Pranë Bashkisë Vlorë kanë paraqitur kërkesat për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara shtetasit si më poshtë:
1. Drita Dosti për apartament me strukturë (1+1), i ndodhur në pallatin nr.1084, shkalla e parë, kati i pestë, nr.19, i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Sipas plan rilevimit të hartuar nga ing.top.i licensuar sipas matjeve në vend ky apartament është pasuria me Nr.54/92+1-19, ZK 8605, me sipërfaqe 49,70 m2, me vendndodhje lagja” 28 Nëntori”, rruga “Anita Bitri”, Rajoni Nr.5 Vlorë.
2. Kastriot Bylyshi për apartamentin me strukturë (2+1), pallati nr.595, shkalla 4. kati 5, apartamenti nr.13, i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Është pasuria me Nr.44/180+4-13, ZK 8601, me sipërfaqe 78 m2.
3. Bashkim Mahmutaj për apartament me strukturë garsonierë, me sipërfaqe 24,80 m2, apartamenti nr.1, i ndodhur në banesën njëkatëshe nr.602, lagja “Pavarësia”, rruga “Abdyl Frashëri”. Është pasuria me Nr.8/36+1-2, ZK 8602.
4. Qani Pasho Latifaj, ka ndërruar jetë, kërkesa është paraqitur nga bashkëshortja e tij në emër të trashëgimtarëve. Apartament i poseduar sipas kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992, me strukturë (1+1), me sipërfaqe 56 m2, i ndodhur në fshatin Shushicë. Është pasuria me numër 163/32+2-3, ZK. 3446 Shushicë.

II. Shtetasit sa më sipër kanë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social» të ndryshuar, neni 77/1,a, në VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” ;

1. Vërtetimin se personi ka pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992.
2. Çertifikatë familjare e 1.12.1992 dhe çertifikatë familjare aktuale.
3. Planimetri dhe plan rievimi të banesës të hartuar nga topograf i licënsuar.
4. Në rastin kur personi që ka pasur kontratë qiraje me shtetin ka ndërruar jetë, dëshmia e trashëgimisë ligjore e nënshkruar nga noteri.
5. Specialistja e strehimit në bashkëpunim me rajonet përkatëse ku ndodhen banesat kanë verifikuar në fakt ekzistencën e banesës, strukturën e banesës sipas kontratës së qirasë dhe planimetrive të hartuara nga ing.top. i licënsuar sipas matjeve në vend dhe kanë mbajtur akt konstatimi për të gjitha rastet.

Sa më lart komisioni

VENDOSI

1. Të miratojë privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara për këto familje.
2. Vlerat e privatizimit për secilën familje të jenë si vijon :
 - Drita Dosti, pallati është ndërtuar në vitin 1975, pra vjetërsia 49 vjet, kategoria e parë, sepse ndodhet në rrugë kryesore. Sipas tabelës bashkëlidhur VKM 179/2020 tarifa e privatizimit 4000 lekë. Kemi përcaktuar koeficientin e bashkëpronësisë $k=0,223$. Indeksi I korrigjimit të çmimeve $i=6,385$. Nga llogaritjet vlera e privatizimit del $=107124$ lekë.
 - Kastriot Bylyshi, pallati është ndërtuar në vitin 1966, vjetërsia 58 vjet. Kategoria e parë. Tarifa e privatizimit sipas tabelës $=4000$ lekë. Koeficienti I bashkëpronësisë $=0,22024$. Koeficienti i $=6,385$. Vlera e plotë e privatizimit $=158687$ lekë.
 - Bashkim Mahmutaj, banesa ndërtim i vjetër Italian. Vlera e ndërtesës $=0$, vlera e truallit dhe vlera e plotë $=171016$ lekë.
 - Qani Latifaj ka ndërruar jetë, janë trashëgimtarët sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore të hartuar nga noteri. Apartamenti ndodhet një pallat dykatësh me 12 apartamente me strukturë (1+1), ndërtim i vitit 1960. Tarifa e privatizimit të banesës dhe vlera e banesës $=0$. Vlera e privatizimit të truallit për sipërfaqe të apartamentit $56 m^2$, çmimi i truallit $(1080 \times 0,3) l/m^2$, indeksin e korrigjimit të çmimeve $=6,385$, është 78778 lekë.
3. Të përgatitet projekt-vendimi për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë, bashkëlidhur të cilit të vendoset edhe Vendimi i Komisionit të Strehimit.

KOMISIONI

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1. Irena Toshkallari | 7. Donald Leskaj |
| 2. Zambak Selmani | 8. Bledar Toja |
| 3. Dorian Demiri | 9. Genard Fegaj |
| 4. Skerdilajd Hunda | 10. Kanan Shakaj |
| 5. Orest Ruçaj | 11. Birçe Aliraj |
| 6. Manuela Prifti | 12. Selim Haskoçela |
| | 13. Drita Mustafai |